



NR. DOKUMENTI	52/4
NR. DOKUMENTI	02
NR. DOKUMENTI	26.02.2014

## KOMISIONI SHQYRTUES

Komisioni shqyrtues në përbërje të:

1. Ylber Aliu, Kryesues
2. Mejreme Cërnoberga, Anëtare
3. Nicolit Sinisa, Anëtar

### Në çështjen e ankesës së:

Ndërmarrja e Re Publike Komonale, Shtërpcë (më tutje: JKP, Shtërpcë), ankesë e bërë me datë: 27. 01. 2014 me Nr 52.

### Kundër vendimit të:

Zyrës Rregullatore për Ujësjetllës dhe Kanalizim (më tutje: ZRRUK), datë: 31. 12. 2013 me Nr 568 / 2, për gjatitjen e JKP, Shtërpcë, në shumën prej 20. 000 Euro (njëzetmijë euro) për operim pa Licencë të Shërbimit.

### BAZA JURIDIKE

1. Neni 34 i Ligjit për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetllës, Kanalizimit dhe të Mbeturinave (më tutje: Ligi Nr. 03/L-086).

### PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

2. Në vendimin e datës: 31. 12. 2013, ZRRUK konstaton se, "JKP Shtërpcë gjatitet në shumën prej 20. 000 (njëzetmijë euro), me që ka bërë shkelje nga neni 32. 1 nënpara (a) të Ligjit Nr 03 / L - 086 dhe neni 6 të Rregullës për Licencimin e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjetllës, Kanalizimit dhe të Furnizuesve të Ujit me shumicë në Kosovë ('R - 01 / U & K') - ofrimi i shërbimeve të ujësjetllës dhe kanalizimit pa pasur licencë të shërbimit".
3. Në arsyetimin e ZRRUK-it lidhur me këtë gjatitje thuhet se, "ZRRUK në pajtim me përgjegjësit që ka për sektorin e ujësjetllës dhe kanalizimit konform neni 1. 4 të Ligjit Nr 03 / L - 086 nuk mund të lejoj ofrimin e këtyre shërbimeve nëse jettike për qytetarët e Kosovës pa pasur licencë të shërbimit. Në këtë kontekst udhëzohen të veprojnë qëllë për (i)

ruajtjen e regionalizimit mbështetur në Vendumin e Kryeministrit mbështetje korporativizimit Nr 06 / 18 e datës: 08. 06. 2011 ku ndërmarrja e juaj do të integrohet në KRUI "Bifurkacioni", Sh. A, Ferizaj apo / ose (i) krijimin e ndërmarrjes së re komunale në pajtim me nenin 11. 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr 03 / L - 087 për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr 04 / L - 111) dhe Rregullores mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike dhe pjesëmarrja e kompanive në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit e Qeverisë së Kosovës (Rregulloja nr 03 / 2013) ku në partaj do të aplikoni për licencë të shërbimit tek ZRRUK".

4. Këtë vendim ZRRUK e nxjerr duke u bazuar: I. Nenin 33. 2 të Ligjit Nr 03 / L - 086 mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004 / 49 mbi Veptrimarinë e Ofruarëve të Shërbimeve të Ujësjellsit, Kanalizimit dhe Mbeturinarëve (Ligji Nr 03 / L - 086). II. Bazuar në shqetësimet e ngritura nga përfaqësuesi i komunës Shtërpcë në Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për regionin e Ferizaq për kaalitetin e ujit, orarin e furnizimit me ujë, raportimit, kush i përcakton tarifat, etj., për ofruarin e shërbimeve të ujësjellsit në komunën e Shtërpcës. III. Mbështetur në raportin e vizitës komunale në Shtërpcë për shqyrtimin e çështjeve të ngritura si dhe shqyrtimin e statusit të Kompanisë e cila ofron shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit në këtë komunë. IV. Refuzimit të pranimit të Paralajmërimit dy herë rradhazi më 11. 12. 2013 dhe 12. 12. 2013 nga JKP Shtërpcë.
5. Ndaj këtij vendimi të ZRRUK-ut, me datë: 27. 01. 2014, me Nr 52, JKP, Shtërpcë ka parashtruar ankesë. Në ankesë, JKP, Shtërpcë, sqaron se, "Këtë vendim e ka marrë Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim në bazë të çregullimit të përmendur nga një përfaqësues i komunës së Shtërpcës në komisionin këshillues të konsumatorëve nga rajoni i Ferizaq lidhur me cilësinë e ujit, orarin të furnizimit me ujë, raporti që përcakton listën e çmimeve të shërbimeve për shërbuesit e shërbimeve të ujit në komunën e Shtërpcës. Nga ky konstatim kaptohet që procesi i këtij vendimi është marrë në mënyrë të paligjshme, dhe e gjithë kjo për shkak që "ZRRUK" nuk e përmend entetin dhe mbicetrin e përfaqësuesit të komunës së Shtërpcës, as datën e takimit në të cilën përfaqësuesi ka shprehur disa çregullime. Në lidhje me akuzat që JKP, Shtërpcë nuk është e regjistruar, përkatësisht nuk ka licencë për ashtërinë e furnizimit me ujë ato janë absolutisht të pasakta, sepse JKP në Shtërpcë, nuk është e regjistruar si kompani e rregullt e cila merret me punën e furnizimit me ujë dhe grumbullimin e mbeturinarëve, kjo gjë mund të kontrollohet në qendrën e regjistrimit për regjistrim të bizneseve në komunën e Shtërpcës". Më tutje ankesa vazhdon "Në lidhje me vet – furnizimin e qytetarëve me ujë në komunën e Shtërpcës, është i njohur fakti se ato punë i kryen kompania jonë dhe atë në një mënyrë profesionale dhe cilësore dhe duke respektuar standardet në të larta botërore në këtë fushë. Vendimet e diskutueshme të ZRRUK-ut, sipas mendimit tonë, janë me qëllim të keq, me motive politike dhe si e tillë përpiqet të diskreditoj dhe nënjël kompaninë tonë".
6. Në ankesë ceket edhe se, "Gjithashtu, me këtë rast dëshirojmë që të përmendim një sërë të parregulltësive formale dhe ligjore në vendim do të thotë preambula e këtij vendimi

*të ZRRUK* i referohet nenit 33, 2 të Ligjit 03 / L - 086, theksojmë se këtij ligji nuk e përmban kurrë nen (sepse ky Ligj për ndryshime dhe plotësime të rregullores së UNMIK-ut nr 2004 / 49), por ai nen nuk është pjesë e Rregullores së UNMIK-ut Nr 2004 / 49, dhe me këtë është e qartë se "ZRRUK" me rastin e marrjes së këtij vendimi është mbështetur në një rregull të pasaktë dhe në këtë mënyrë ka bërë shkelje esenciale të drejtës materiale". Po ashtu në ankesë ceket se, "...sipas ZRRUK, se NJKP në Shtërpecë dy herë ka refuzuar paralajmërimet nuk është absolutisht e saktë sepse zyrtarët e ZRRUK-ut asnjëherë nuk e kanë vizituar kompaninë tonë". Praendaj "Duke pasur parasysh që ZRRUK me rastin e marrjes së vendimit të diskutueshëm absolutisht ka gjetur gabimisht faktet dhe gabimisht ka aplikuar ligjin në dëm të kompanisë tonë, kërkto që i propozojmë Komisionit Shqyrtues që këtë vendim të ZRRUK ta anulojë si të paligjshëm".

## PREZENTIMI I ARGUMENTEVE

7. Komisioni shqyrtues në takimin e mbajtur me datë: 14. 02. 2014, konformë nenit 34, pika 34, 4, të Ligjit Nr 03/L-086, ka dëgjuar argumentet e përfaqësuesit të ZRRUK-ut lidhur me vendimin, dhe argumentet e përfaqësuesit të JKP, Shtërpecë lidhur me ankesën.

8. Anëtarja e ZRRUK-ut në Komisionin shqyrtues,

*"I xjefitë të prarilimit lidhur me aktivitetin e zhoilluar qosh para 2 vjetësh nga ana e ZRRUK lidhur me operimin e kësaj Kompanie pa licencë. Qosh nga atëherë nga ana e kësaj kompanie nuk kemi marrë kurrfarë informacione apo hapa konkret për të zhoilluar procedurat e licencimit tek ZRRUK. Ajo çka na ka shtyrë tani të ndërmarim hapa konkrete është se përfaqësi i komunës në Shtërpecë në KKK ka shpallur shpëtimin e qytetarëve të kësaj komune lidhur me shërbimet e ujit, tarifat të cilat aplikohen nga kompania në fjalë. Pas këtij shpëtimin, kemi vizituar komunën e Shtërpecës. Arsyetimi i juaj se Vendimi i ZRRUK për gjohë ka praparijë politike, ka për qëllim me e nbyll kompaninë dhe ka të meta juridike-formale, nuk është e qëndrueshme dhe është e padrejtë, sepse ZRRUK në bazë të kompetencave të saja ligjore ka marrë qëndrim për licencimin e të gjitha kompanive dhe të njëjtat të integrohen në ato Regjionale apo të themelohen si ndërmarrje lokale publike. Se ky vendim nuk është politik, ju përkujto dhe argumentoj se për të njëjtat arsye është gjohëtar kompania në Kaçanik, si dhe kompanitë tjera komunale të ju licencuara, duke marrë parasysh rëndësinë dhe rolën e këtij resursi. Për ZRRUK nuk është e rëndësishme se kompania e juaj a do të punoi në koadër të Komunës apo regionalizimit. Arsyetore është licencimi dhe legalizimi i firmës".*

9. Ndërsa, anëtarja e JKP, Shtërpecë në Komisionin shqyrtues sqaroi se, "Në kompani ka pasur ndryshime kadrovike dhe situata ka qenë e tensionuar, dhe për këtë arsye askush nuk ka dashur me pranisë shkresën", duke ju refuzuar paralajmërimet. Ai pohoi se, "Kompania kryesisht merret me shërbimet e ujit". Poashtu sqaroi se,

*"Ai tha se kompania ekziston nga viti 1991 dhe është e regjistruar nga Komuna. Po ashtu edhe nga gjykata ekonomike e kemi shkresën dhe si veprimtari kryesore e kemi ujin. Kemi shumë shpenzime, dhe në kompani punojnë shqiptarë dhe serbë. Dhe është kompani e interesit të përgjithshëm. Por pa një profit. Dënim prej 20.000 € do ta ngarkonte shumë kompaninë dhe do*

*te rezultante populatën, dhe mos furnizimi me ujë do të jetë katastrofë. Ky Vendim është i gabuar dhe i ngutshëm në bazë të deklaratës të përfundimit të komunës, pa u vërtetuar gjendja reale”.*

#### VLERËSIMI

10. Komisioni shqyrtues vlerëson se ankesa e JKP, Shërbëcë, është bërë brenda afatit kohor ligjor prej 15 ditë pune dhe si e tillë është e pranueshme.
11. Komisioni shqyrtues ka gjetur se, deri me datë: 21. 02. 2014, JKP, Shërbëcë, ka vepruar pa Licencë të Shërbimit të lëshuar nga Rregullatori, as nuk ka aplikuar për marrjen e një licence të tillë dhe as nuk ka figuruar në kuadër të Certifikatës së Shërbimit të ndonjë ofruesi tjetër të shërbimeve publike të ujit që ka Licencë të Shërbimit nga ZRRUK-u.
12. Pra, JKP, Shërbëcë, ka ofruar shërbime publike të ujit për konsumatorët e vet pa pasur Licencë të Shërbimit për këtë aktivitetet. Kompania vet ka caktuar dhe miratuar tarifat për konsumatorët dhe vet ka mbikëqyrur standardet e shërbimit.
13. Komisioni shqyrtues ka gjetur se, duke vepruar pa Licencë të Shërbimit, JKP, Shërbëcë, ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 3 Ligji Nr. 03/L-086, ku përcaktohet se:

*“Asnjë person nuk mund të ofrojë shërbime në Kosovë pa lejen për shërbime përkatëse”.*

14. Dhe me nenin 1.4 të Ligji Nr. 03/L-086, ku përcaktohen se:

*“Rregullatori është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve në pronësi shtetërore dhe publike të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë. Rregullatori merr vendime të pavarura gjatë ushtrimit të përgjegjësisë në bazë dispozitave të këtij Ligji ose çfarëdo rregulloreje ose ligji në fuqi dhe çfarëdo urdhërese administrative, udhëzimi administrativ ose vendimi tjetër i cili mund të ndihet në vijim”.*

15. Po ashtu Rregulla R - 01 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë, konkretisht neni 6, përcakton se:

*“Të gjitha Ndërmarrjet Publike në Kosovë që tani ofrojnë Shërbime të Ujit dhe të Ujërave të Zeza duhet të aplikojnë te Rregullatori për Licencë të Shërbimit sipas dispozitave të kësaj Rregulle”.*

16. Prandaj, dhe duke pasur parasysh këto fakte, Komisioni shqyrtues në takimën e mbajtur me datë: 21. 02. 2014:

#### VENDOS

1. Mbetet në fuqi vendimi i ZRRUK-ut Nr 568 / 2, me datë: 31. 12. 2013.
2. Hedhet poshtë ankesa e JKP, Shtërpecë, Nr 52, me datë: 27. 01. 2014.
3. Obligohet JKP, Shtërpecë, të veprojë në pajtim me nenin 33. 3 (b) të Ligjit Nr 03/L-086.
4. Obligohet JKP, Shtërpecë, të veprojë në pajtim me nenin 32. 4 të Ligjit Nr 03/L-086.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e lëshimit.

**Këshillë juridike:** Në bazë të nenit 35 të Ligjit Nr. 03/L-086, palet e pakënaqura me këtë vendim mund të parashetrojnë ankesë në Gjykatën Kompetente për shqyrtim brenda rreth (1) muaji nga data kur ofruesit të shërbimeve i është dorëzuar me shkrim vendimi përkatës nga Komisioni Shqyrtues.

Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues:

Ylber Alin

